

të Hamides në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Bellacërkë/Bela Crkva.

Burimet: deklarata S.P, FDH-17101; *Rahovec in Flames and Smoke Amidst Continued Serb Shelling*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372.

Ibrahim (Xhemajl) Popaj

(1918, shqiptar nga Bellacërka/Bela Crkva, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, tetë fëmijë)

Hazire (Ahmet Fetahu) Popaj

(15.02.1925, shqiptare nga Celina/Celinë, komuna e Rahovecit/Orahovac, amvise, tetë fëmijë)

Ryvije (Jupë Spahi) Popaj

(9.07.1933, shqiptare nga Opterusua/Opteruska, komuna e Rahovecit/Orahovac, amvise, pesë fëmijë)

Pjesëtarë të UJ-së, që nga mëngjesi i datës **19.07.1998**, e bombardonin Rahovecin/Orahovac dhe Bellacërkën/Bela Crkva. Rreth orës 16:00, forcat policore hyrën në **Bellacërkë/Bela Crkva** dhe filluan tu vënin zjarr shtëpive të fshatit. Banorët e braktisën fshatin. Për shkak të moshës, Ibrahim, bashkëshortja Hazire dhe bashkëshortja e të vëllait Ryvija ndenjen në shtëpinë e Ibrahimit. Në mbrëmje, i biri dhe nipi i Ibrahimit dhe Hazires u kthyen në shtëpi për të parë çfarë kishte ndodhur me pleqtë. I gjetën që të tre të vranë. Ibrahim ishte i ekzekutuar me një plumb në kokë, ndërkaq Hazirja dhe Ryvija ishin qëlluar me plumba në gjoks. Pas katër ditësh, familjarët i varrosën viktimat në oborrin e shtëpisë. Në datën 5.07.1999, mbetjet mortore të viktimave janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Bellacërkë/Bela Crkva.

Burimet: deklarata B.P, FDH-13621; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-26205; *Rahovec in Flames and Smoke Amidst Continued Serb Shelling*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372.

Zyrafete (Hajdar Hoti) Krasniqi

(24.05.1972, shqiptare nga Drenoci/Drenovac, komuna e Rahovecit/Orahovac, amvise, një fëmijë)

Emine (Hamdi) Krasniqi

(10.02.1976, shqiptare nga Drenoci/Drenovac, komuna e Rahovecit/Orahovac, amvise)

Në datën **19.07.1998**, nga ora 07:00, forcat serbe filluan të bombardonin fshatin [**Drenoc/Drenovac**] nga drejtimi i *Prishit të Hasit* [komuna e Djakovës/Dakovica]. Në atë çast, Zyrafetja dhe bashkëshortja e të vëllait Eminja ishin duke ndenjur me familjarë të tjerë në oborrin e shtëpisë. Kur në fshat ranë predhat e para, ato ia dhanë vrapit për tu strehuar në brendi të shtëpisë. Përderisa vraponin, një predhë ra në oborr. Ciflat e saj e qëlluan Zyrafeten në gjoks, ndërkaq Eminen në kokë. Dhanë shpirt në vend. Po atë ditë, rreth orës 13:00, kur bombardimi pushoi, familjarët e varrosën Eminen dhe Zyrafeten në varrezat lokale.

Burimet: deklarata A.K, FDH-15488; *Heavy Fighting Resume in Rahovec and Adjacent Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 19.7.1998, FDH-29368.

Veli (Imer) Haxhimustafa

(1.10.1930, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, gjashtë fëmijë)

Muharrem (Asllan) Alisallahu

(25.04.1934, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor, tetë fëmijë)

Veliu ka qenë një njeriu i urtë dhe i respektuar në Rahovec/Orahovac. Merrej me bujqësi. Komshiu i tij Muharremi punonte në fabrikën *18 Nëntori*. Që të dy mbetën në shtëpitë e veta, kur familjarët e tyre e braktisën qytetin e Rahovecit/Orahovac më 19.07.1998. Familja e Veliut u strehua në Dragobil/ Dragobilje [Malishevë/Mališevo], ndërsa ajo e Muharremit në Turjakë/Turjak. Dy ditë më vonë, një komshi i familjes Haxhimustafa i ka lajmëruar djalin të Veliut se i ati dhe Muharremi ishin vranë, dhe se ai i kishte parë trupat e tyre më **20.07.1998**, në oborrin e komshiut Miftarem Zllanoga [**Rahovec/Orahovac**]. Djemtë e Veliut, Vahedeti dhe Elviu, u kthyen ditën tjetër, më 3.08.1998, në Rahovec/Orahovac. Në oborrin e Miftaremit i kanë gjetur trupat e copëtua të Muharremit dhe Veliut. Djemtë i kanë varrosur mbetjet